

**MITRUSH KUTELI AS A NARRATOR AND GENRE  
TRANSFORMATIONS**

**MITRUSH KUTELI SI RRËFIMTAR DHE TRANSFORMIMET  
ZHANRORE**

**Fatjona ABDULLAHI<sup>1</sup>**

<sup>1\*</sup> *Department of Albanian Language and Literature, Faculty of Philology, University of Tetova*

<sup>\*</sup> *Corresponding author e-mail: fatjona.abdullahi@unite.edu.mk*

---

**Abstract**

The influence of folklore in literature is not a new or unknown phenomenon, nor has it been so for Albanian writers between the two World Wars. Mitrush Kuteli is known as one of the first founders of Albanian prose of modernism, but at the same time, he is also known as a master storyteller who transcends genre structures and reintroduces popular motifs in the form of literary invariants. We say in the form of literary invariants because despite the literary processing he undertakes, the essence of folk ballads, songs, and tales remains unchanged, preserving even the unmotivated compositional ruptures and filling them with authorial artistic interventions such as descriptions, phraseologies, parodies, etc.

However, we do not see attempts at alienating subjects and hypertextual transformations, which implies that Kuteli's aim was the actualization of folk literature with fidelity to compositional construction, character functions, narrative balances, and the fundamental ideas of the processed material.

**Keywords:** prose, modernism, genres, literature, folklore, motifs, ballads, folktales.

---

Ndikimi i folklorit në letërsi, nuk është dukuri e re dhe e panjohur e as nuk ka qenë e tillë për shkrimtarët e letërsisë shqiptare në mes dy luftërave botërore. Mitrush Kuteli, gëzon atributet e njërit nga themeluesit e parë të prozës së mirëfilltë moderne shqiptare, por njëherit njihet edhe si rrëfimtari mjeshtër i cili kapërcen mes strukturave zhanrore dhe risjell motive popullore në trajta të reja, të përvetësuara sipas kontekstit të caktuar historik e shoqëror. Kuteli vetë pohon se “bazën e vërtetë letrare ma dhanë përrallat e gjyshes e të fqinjit, folklori ynë i pasur, që nisa ta njoh që nga vogëlia. Përrallat e dëgjua ose të lexuara ishin ato që më mbujtën në moshë të njomë. Pastaj tregimet gojore të njerëzve tonë, sidomos të pleqëve, pranë zjarrit e në hije të drurëve, ngjarje të moçme, luftra, ngjarje të mërgimit”<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup> Sabri Hamiti, *Letërsia moderne shqiptare*, Albas, Tiranë, 2000, f. 123.

<https://doi.org/10.62792/ut.filologjia.v12.i22-23.p2534>

Në njëfarë forme, ai dëshmon mbi referencat e krijimeve të tij të cilat janë të brumosura nga thesari popullor dhe me shënimet që bën në formë parateksti, jep indicie për fillimet e karakteristikave të komunikimit ndërzharror në formë invariantesh për faktin se pavarësisht përpunimit letrar që bën, megjithatë ruhet i pandryshueshëm thelbi i baladave, këngëve dhe përrallave popullore, duke u ruajtur edhe shkëputjet e pamotivuara kompozicionale dhe duke u plotësuar të njëjtat me ndërhyrje artistike autoriale, në formë përshkrimesh, frazeologjish, parodizimi etj.

Shkrimtarë si Mitrush Kuteli kanë shërbyer si urë lidhëse mes trashëgimisë folklorike dhe formave moderne të shprehjes letrare. Kuteli, si një nga themeluesit e prozës moderne shqiptare, ka arritur të rikrijojë dhe transformojë motive popullore në mënyrë të tillë që ato të mbeten të freskëta dhe të gjalla për lexuesit e kohës së tij dhe lexuesit të mëvonshëm. Në këtë punim do të shqyrtojmë se si Mitrush Kuteli ka përdorur elementet e folklorit në krijimtarinë e tij letrare, duke analizuar mënyrat me të cilat ai ka integruar këngët, baladat dhe përrallat popullore, në prozën e tij.

“Kuteli është jo vetëm mjeshtër i novelës e tregimit, por edhe mjeshtër i ritregimit. Gjithmonë duke qenë i preokupuar me çështjen e anamnezës së kësaj pjese të bukur të trashëgimisë kulturore e letrare shqiptare, Kuteli i përvishet punës që të ritregojë motivet nga bota e pasur e baladave dhe rapsodive popullore shqiptare, duke ndryshuar tipin e tekstit, nga ai poetik në atë prozaik. Vetë raporti i vendosur ndaj bazamentit oral, pra ai i ritregimit, dëshmon se më tepër se tekstin e ri, nëpërmjet të metodologjisë së përzgjedhur – ritregimit, Kuteli mundohet të aktualizojë tekstin e vjetër, i vetëdijshëm se zvetëni i tij paraqet humbje të një trashëgimie ndaj të cilës, jo vetëm që duhet patur respekt, por me të cilën edhe duhet ushqyer shpirtërisht gjeneratat e reja.

Kuteli është i vetëdijshëm se transformimi zhanrovik i veprës nga ajo poetike në atë prozaikë, ia humb asaj *tharmin poetik*, andaj tregohet i kujdeshëm me përdorimin e suksesshëm të mundësive që ofron shprehja letrare prozaikë, që një mjeshtër i prozës i kishte të njohura.”<sup>2</sup> Pra, siç nënkuptohet, investimi intelektual dhe artistik i Kutelit është i përqendruar në shpalosjen e krijimtarisë gojore, të përshtatur dhe të përpunuar sipas normëzimit të caktuar zhanrovik dhe sipas predispozitave që ai vetë gëzonte për të bërë komunikim me letërsinë gojore, e cila në variantin e ri, nuk rrezikohej as në tema, as në motive e as në funksionin estetik fillestar.

Kuteli gjithashtu e kishte të qartë se në qoftë se në jetën përditshme, ngjarjet ekzistojnë dhe janë pjesë e realitetit edhe kur nuk rrëfohen, letërsia e kërkon doemos rrëfimitarin për t’u dhënë jetë personazheve dhe për ta njohur veprimin përmes rrëfimeve dhe, pikërisht në veprën e Kutelit, ajo që bie në sy është mjeshtria narrative dhe mënyra e transformimit nga njëri zhanër në tjetrin, duke u përqendruar në ndërtimin e dialogëve, përshkrimin e personazheve, radhitjen kompozicionale, ndërfutjen e elementeve mitologjike, rrjedhshmërinë e ngjarjes dhe kompleksitetin tematik.

Krijimtaria letrare organizohet, ekziston dhe përhapet nëpërmjet *zhanrit*, i cili si sistem i porosive poetike përmban llojin sipas të cilit teksti formësohet dhe e fiton formën e tij përfundimtare. Në këtë mënyrë dallohet nga të tjerët – paraardhësit, si krijim i veçantë; por njëkohësisht prej tyre ruan disa elemente, me të cilët e ruan traditën dhe përfshihet në rrjedhën e përcjelljes së saj, *nga njëra anë*; por përgjithësisht dallohet nga llojet e tjera të veprimtarive njerëzore, *nga ana tjetër*.<sup>3</sup> Zhanri jo vetëm që përcakton parametrat dhe karakteristikat e formësimit të një teksti, por edhe shërben si një mjet për identifikimin dhe dallimin e tij nga krijimet e mëparshme. Ky proces i diferencimit dhe ruajtjes së elementeve tradicionale është esencial për të kuptuar evoluimin e letërsisë brenda një konteksti të caktuar kulturor dhe historik.

<sup>2</sup> Mirlinda Krifca, *Raporti i prozës së Mitrush Kutelit me letërsinë gojore*, Konferencë Shkencore “Mitrush Kuteli në 110-vjetorin e lindjes”, Universiteti “Fan Noli” – Korçë, 2017.

<sup>3</sup> Zeqirja Neziri, *Çështje të letërsisë shqiptare*, Instituti Alb-Shkenca, Shkup, 2023, f.13.

Përmes zhanrit, krijimet letrare arrijnë të jenë unikale dhe të reja, duke kontribuar në pasurimin e trashëgimisë kulturore dhe duke u bërë pjesë e vazhdimësisë së saj. Kështu, zhanri letrar jo vetëm që e bën të mundur organizimin dhe ekzistencën e tekstit letrar, por edhe e pozicionon atë në një dialog të vazhdueshëm me traditat dhe inovacionet e letërsisë, duke e dalluar në të njëjtën kohë nga format e tjera të veprimtarive njerëzore.

Përndryshe mbi kulturën e oralitetit, gjerësisht në botë, herët është shfaqur shqetësimi se letërsia ishte bërë për t'u dëgjuar dhe jo për t'u lexuar e kjo natyrisht duhet bërë objekt studimi në kontekst të karakteristikave të një letërsie për qëllime të performancës orale.<sup>4</sup> Një dorë shpëtimi në këtë rast në kontekst shqiptar, Kuteli ia jep kësaj letërsie thjesht dëgjimi dhe e transformon në letërsi të lexueshme, madje edhe mjaft të përshtatshme për kohën kur ai vepron. Pikë tjetër është bashkëpërkimi i letërsisë orale të një populli me letërsi të tjera të popujve të tjerë prej të cilëve është izoluar dhe kjo jep shkas për supozimin se ekziston specifikisht modeli oral i poezisë dhe narrativës.<sup>5</sup>

Në këtë drejtim, ndonëse jo në kontekst të popujve të ndryshëm por në kontekst të varianteve, Kuteli përkujdeset të evidentojë ngjashmëritë dhe diferencat mes një balade të arbëreshëve fjala bie, me një baladë tjetër tek e cila gjejmë elemente islamike të mëvonshme. Nuk ngurron as të japë përshtypjet e tij dhe preferencat estetike, ndaj motiveve të një balade kundrejt një tjetre (“Besa e Konstandinit” dhe “Halil Garria”). Së fundi, nëse mesazhet e transmetuara në një formë komunikimi nuk janë të pavarura nga mënyra në të cilën janë komunikuar, përkundrazi, mjetet e transmetimit kanë efekte të thella dhe ndikim të gjerë në përmbajtjen e mesazhit, respektivisht ekziston një mendësi orale specifike.<sup>6</sup>

Njësoj siç pretendohet se poezia orale gjithësesi se ka një model specifik për zhanrin e saj, po kështu edhe transformimi i të njëjtave në përralla e rrëfime, mund të mbështesë qëndrimin se të gjitha përrallat kanë të njëjtin model strukturimi. Po Kuteli sjell personazhe të cilat, i tejkalojnë modelet e strukturalistit Vladimir Propp, i cili ka dhënë 35 funksionet e përrallës, të cilat jetojnë në çdo krijim të këtij lloji në formë elementesh stereotipike të veprimit, që ndodhin në rend të pandryshueshëm. Respektivisht nëse kemi mes tjerash; heroin e panjohur, që arrin në shtëpi a në vend tjetër, heroin e rremë që parashtron kërkesa të pabaza, heroin të cilit i jepet një detyrë e rëndë, detyra zgjidhet dhe heroi njihet; këto funksione, nuk janë hapa konkretë të cilët paraqesin veprimet, por janë dhënë për të depërtuar në strukturat e thella të narrativës.

“Rruga e transformimit të jetës reale në “jetë përralore” krahasohet me procesin e formimit të kripës së detit. Kjo lind nga deti nëpërmjet avullimit (largimi nga gjendja e parë) dhe e merr formën e përmbajtjen e vet jashtë tij. Por mjafton pas kësaj procesi i kundërt, rikthimi në ujë, për ta shkatërruar krijesën e re. Edhe përralla që lind nga realiteti nëpërmjet një procesi “avullimi” (të ligjeve reale), do të vdiste po ta fusje përsëri në këtë realitet, po ta gjykojmë me sytë e “realitetit”, po të kërkojmë nga ajo zbatimin e ligjeve fizike objektive.”<sup>7</sup>

Kështu sa i takon kapërcimit zhanror që Kuteli bën, vlen të theksojmë se transformimi, respektivisht risjellja e këngëve të kreshnikëve, legjendave e baladave brenda kontureve prozaike, bëhet në mënyrë të ndërgjegjshme dhe kurrsesi fjalëpërfjalshëm ose *ad literam*. Format që marrin, janë të plotësuara nga autori edhe me kontekst jashtëletrar, por nga ana tjetër shohim edhe shumë pasazhe metanarrative, në të cilat Kuteli nuk ngurron të ndajë “gjykimin” si rrëfimtar ndaj veprimeve të personazheve duke na rrëfyer mbi rrëfimet që janë pjesë e syzheve, thelbi i të cilëve është ruajtur me besnikëri. S. Hamiti, lidhur me këtë veçori, është shprehur: “Thelbi është se Mitrush Kuteli nuk rrëfen ngjarje, por rrëfimin mbi ngjarjen. Ndaj, autori merr një rol të ndërmjetësit midis rrëfimit me dëgjuesin apo me lexuesin”<sup>8</sup>

<sup>4</sup> Thomas A. Shmitz, *Teoria moderne letrare dhe tekstet antike*, Albas, Tiranë, 2019, f.133.

<sup>5</sup> Po aty.

<sup>6</sup> Po aty.

<sup>7</sup> Astrit Bishqemi, *Letërsia për fëmijë*, SEIKO, 1997, f.121.

<sup>8</sup> Sabri Hamiti, *Letërsia moderne shqiptare*, Albas, Tiranë, 2000, f. 123.

Në të shumtën e herave, Kuteli shihet pra, duke dialoguar me personazhet e shumë shpesh edhe me recipientin. Ndër vështirësitë më të mëdha të rrëfimitarit është përfshirja në psikën e personazheve që meqenëse vijnë nga baladat, janë të mveshura me petkun edhe të historisë edhe të mitologjisë dhe kësaj duhet respektuar uniteti i këtyre dy segmenteve, duke u respektuar edhe thyerja e kufijve hapësinorë e kohorë që përralla i ka karakteristikë të veten.

Floresha Dado thotë se dialogu e bën rrëfimin më të gjallë, më konkret. Ai i jep kësaj gjinie (epikës, prozës) veçori që i ka huajtur nga gjinia dramatike (...) Kjo mënyrë organizimi e ligjëritimit që është karakteristikë për dramën i ka dhënë gjinisë epike gjallëri të veçantë, një komunikim më të natyrshëm dhe të drejtpërdrejtë midis personazhit dhe lexuesit.<sup>9</sup> Pra, duket se përmes dialogëve të personazheve ne arrijmë të marrim më shumë informacion sesa përmes përshkrimeve reduntante që vijnë nga baladat apo këngët epike. Këngët, që janë pjesët përbërëse të eposit, zakonisht përfshijnë vargje të gjata, me një numër të madh dhjetërokëshash, me një shprehje të gjerë.

Mendimi specifik brenda eposit të kreshnikëve karakterizohet nga një lëndë poetike e gjerë dhe lidhet drejtpërdrejt me poetikën mitologjike. Kjo realizohet përmes një vargu figurash mitike, të tipit shqiptar, që në epos kanë cilësinë e personazheve artistike: nga Zanat te Orët, deri te Shtojzovallet dhe gjarpërinjtë që japin fuqi kreshnikëve ose shërojnë plagët; nga zogjtë që paralajmërojnë ngjarjet deri te vendet e kulteve pagane dhe trupat qiellorë që komunikojnë me njerëzit. Përfshirja e këtyre elementeve mitologjike e bën eposin shqiptar një rrëfim të mrekullueshëm me një thellësi kulturore dhe historike dhe bartja e temave nga cikli i këngëve të kreshnikëve për Kutelin në këtë rast duket se vjen natyrshëm sepse elementet fantastike si prania e Orëve, Zanave dhe figurave të tjera mitologjike e plotësojnë mozaikun që i duhet përrallës.

Northrop Fraj njëri nga teoricienët që është marrë me ndarjet zhanrore në letërsi referon se kemi tri organizime të miteve dhe simboleve arketipore në letërsi, ndërsa në të gjitha këto i gjejmë të shfaqura në veprën e Kutelit. Sipas Frajit “Fillimisht, kemi mitin e zhvendosur i cili merret me zotër e demonë dhe merr formën e dy botëve të kundërta të identifikimit metaforik, një të dëshirueshme dhe tjetra të padëshirueshme. Së dyti, kemi tendencën e përgjithshme që e kemi quajtur romantike për të sugjeruar monstra të nënkuptuara mitike në një botë të shoqëruar ngushtë me përvojën njerëzore. Dhe, së treti, kemi tendencën e realizmit për ta vënë theksin në përmbajtje dhe në prezantim, më parë sesa në formën e tregimit.”<sup>10</sup>

Analizuar në kontekst të veprës së Kutelit, e cila buron nga thesari popullor, të trija këto dispozita të Frajit qëndrojnë dhe gjejnë zbatim. Miti i zhvendosur shfaqet jo pak në rrëfeja duke përfshirë figura hyjnore si zotër dhe demonë dhe duke përshkruar dy botë të kundërta në mënyrë metaforike. Njëra botë është e dëshirueshme (pozitive), ndërsa tjetra është e padëshirueshme (negative). Kjo ndarje simbolike ndihmon në krijimin e një kuptimi më të thellë përmes kontrasteve, ndërkaq gërshetimi i kuptimit metaforik është mjaft i shpeshtë. Kemi rrethanat kur fjala bie, bota tektonike është e paraqitur si ana e errët e jetës dhe frika e të gjallëve, por kemi dhe situata kur pikërisht kjo botë e nëndheshme bëhet e dëshirueshme dhe synim i të gjallëve të cilët ndëshkohen me pavdekësinë mbi tokë (Tat Tanushi).

Tendenca romantike nënkupton se brenda botës së përvojës njerëzore ka figura mitike ose monstra që përfaqësojnë elemente të fshehta dhe të thella të psikës njerëzore. Në letërsinë romantike, këto elemente mitike janë të integruara dhe të sugjeruara për të reflektuar ndjenjat, frikërat dhe dëshirat njerëzore. Ndërsa tendenca realiste i jep rëndësi më të madhe përmbajtjes dhe prezantimit të tregimeve, sesa formës së tyre. Ajo përqendrohet në detaje të sakta dhe realiste, duke bërë që tregimet të duken më të besueshme dhe më të afërta me jetën reale.

<sup>9</sup> Floresha Dado *Proza nëpër teknikat poetike*, f. 205.

<sup>10</sup>Northrop Fraj, *Anatomia e kritikës*, Rilindja, Prishtinë, 1990, fq.188.

Mund të themi se në botën e mitit, ngjarjet dhe veprimet nuk janë të kufizuara nga përvoja jonë e zakonshme ose e njohur e realitetit. Në vend të kësaj, mitet janë krijime që imitojnë veprimet që janë afër ose brenda kufijve të dëshirave njerëzore dhe përmbushin dëshirat, idealet dhe aspiratat e njerëzve, pavarësisht nëse këto janë të arritshme në botën reale apo jo. Ky proces i "projektimit drejt qiellit" u jep një formë të shenjtë dhe të përjetshme përvojave njerëzore, duke i bërë ato më të kuptueshme dhe më të menaxhueshme për njerëzit.

Në këtë mënyrë, mitet shërbejnë si një mënyrë për të trajtuar dhe përpunuar çështjet komplekse psikologjike dhe emocionale në një mënyrë që është simbolike dhe metaforike. Prandaj komunikimi ndërmjet botës së përtejme dhe botës së këndeje që e kanë personazhet e Kutelit, prania e figurave mitologjike si Zanat, Të Lumet, Të Bardhat, Shtojzovallet, Kukudhi, Lugati etj., lehtësisht mund të jetë objekt i një qasjeje psikanalitike për të kuptuar kësaj here jo rrethanat autoriale, por etnopsikologjinë e popullit nga i cili ka dalë materia e shndërruar në rrëfenjëza.

Kuteli "paraqet në formën e rrëfenjave letrare, me një stil të veçantë shkrimi, një varg temash e motivesh, të cilat mishërohen përbrenda përmbajtjes dhe ideve të prozës së tij,"<sup>11</sup> dhe mund të themi se përkrah motiveve të shumta, motivi i rinjohjes (i gruas me burrin, vëllait me motrën, vëllait me vëllanë etj.) është ndër motivet më të shpeshta që shfaqet i bartur nga baladat shqiptare në trajtë tregimi. Të vëna në paralele, këto forma narrative Kuteli i sjell përmes tonit të rrëfimitarit të gjithanshëm i cili ka të drejtë të gjykojë mbi vendimet që marrin personazhet dhe jep informacionet sikur të jetë ngarkesë e tij për të cilën i detyrohet lexuesit.

Kësisoj në momentin e kthimit të Halil Garrisë me të motrën në kalin shaluar teksa ajo e pyet për ndodhitë dhe rrjedhën e jetës, kur ai i devijon nga e vërteta si një i ardhur nga përtejvarri, nuk vonon interpretimi se "vëllai po gënjen të motrën" megjithëse i ardhur nga gjuhë zogjsh e qyqesh (elementë kumti në baladat ndërballkanike)... Një tjetër moment i ngjashëm, është edhe kthimi i Ymer Agë Ulqinit pas nëntë vjetësh për t'u rinjohur me gruan dhe vonesa e rinjohjes me mamën e tatën, të cilëve u thotë se Ymer Agës "ia ndau të shtatëzën me duart e veta". Edhe në këtë rast, nuk mungon ndërhyrja që rrëfimtari e sheh të udhës ta bëjë, sikur të ketë drojë se mos lexuesi ndihet i përhumbur në vijën syzheore.

Motiv tjetër i pranishëm është ai i murimit, i cili nga legjenda bartet në formë tregimi. Besa dhe motivi i ringjalljes kryesojnë të përdorura në disa variante, (arbëresh dhe i mëvonshëm islamik), ndërsa prania e elementeve fantaste dhe mitologjike, përbën pjesën masive të ndërtimit kompozicional të tregimeve e rrëfejavave që Kuteli i nxjerr nga shtresëzimet më të thella të cilat dëshmojnë për lashtësi motivesh deri në kohën e paganizmit. Siç Todorov do të shprehë se "Në një botë që është e jona, të cilën e njohim pa djaj, shtojzovalle e vampirë, ndodh një fenomen që nuk mund të shpjegohet me ligjet e botës që na rrethon."<sup>12</sup> ashtu edhe Kuteli ndan shqetësimet e tij për lexuesin sa herë që i prezanton një figurë të re prej Lugati i cili nga graviteti i mëkateve të kësaj bote, nuk mbijeton dot në botën e nëndheshme dhe si shpirt i trazuar, trazon fshatarët.

Normalizimi që i bëhet bashkëjetesës me personazhe fantazmagorike, çon drejt asaj që Jungu e ka njohur si pavetëdija kolektive, e cila përfaqëson trashëgiminë shpirtërore të qenies njerëzore dhe e cila, natyrisht është e stërmëshur me figura që kanë ushqyer besëtytnitë, rrëfimet misterioze, totemizmin e shfaqur, tabutë etj. Nuk mungojnë episodet kur dashuria ka fuqinë të martojë një të vdekur me një të gjallë (Rinë Katerinëza dhe Killoroji) dhe po dashuria dhe malli kanë fuqinë të shkatërrojë magjinë e t'i dënojnë që të tre (bashkë me nënën e Kirollojit). Mëkati si kategori e dënueshme nga Zoti, i shoqëron në përditshmëri protagonistët e Kutelit, madje edhe në momentet plot hilaritet të një fshati që në vend të ujit pinte rakinë dhe si në festat për nder të hyjit Dionis, deheshin që në mesditë.

<sup>11</sup> Sali Bashota, *Kuteli prozator, poet, kritik*, Rilindja, Prishtinë, 1999, fq.13.

<sup>12</sup> Tzvetan Todorov, *Hyrje në letërsinë fantastike*, përkthyer nga Gjovalin Kola, Pika pa sipërfaqe, Tiranë, 2015, fq.32.

Goditjet që i jep feudalizmit, (Vjeshta e Xheladin Beut, Natë Kollozhegu, Si e gjeti Ago Jakupi rrugën e Zotit etj.) janë pjesët më të bukura ku Kuteli i fton personazhet në katarsë, duke i kërcënuar madje me dënimin e përjetësisë me kthim karmik të së keqes, me poshtërim dhe pendesë në momente decizive. Kështu kemi një Ago Jakupi i cili “gjeti rrugën e Zotit” në fund të një shekulli që po mbushte dhe shohim se “nuk kishte frikë nga vdekja, por nga jeta që zgjatej kaq fort”.<sup>13</sup>

Në fund arrihet spastrimi dhe, kopracisë që e karakterizonte, i lëshon udhë dhe shkon në drejtim të “mëshirës së Zotit”. Rrëfimi kutelian, shumë shpesh është cilësuar se i ngjan gjuhës së folur, pra ai shkruan ashtu siç flet e në këtë rast kemi parasysh shtresëzimet kuptimore dhe fuqinë shprehëse të cilat i zotëron. Por, sa i takon shndërrimit nga njëri zhanër në tjetrin duket se Kuteli e njeh ndjeshmërinë dhe shprehet: “Të përpiqesh ta kthesh këngën në tregim është pothuajse e njëjta gjë sikur të përpiqesh ta futësh qiellin e kaltër në një kuvli të errët apo ta ngjeshësh tërë pranverën brenda në trastë.”<sup>14</sup>

Narracioni i baladave dhe përrallave ndryshon që në terma të origjinës së tyre, përmbajtjes dhe qëllimit. Baladat janë rrënjëzuar në traditën orale, fokusohen në ngjarje më intime dhe janë të karakterizuara nga melodizmi dhe redundancat e theksuara, ato, ndryshe nga këngët e eposit heroik, duke trajtuar elemente të jetës familjare, kanë fituar karakter ritual. Ndërkaq, përrallat tek të cilat po ashtu Kuteli ka marrë gjedhen e krijimit të tij tregimtar, mësojnë mbi shumë probleme të botës së brendshme të njeriut dhe mbi zgjidhjen e mundshme ose të drejtë të tyre. Në prozën tonë, në këtë rast, kemi përralla, që kanë shërbyer si shtrat, mbi të cilin kanë hedhur shtat këngë, që përfshihen në eposin heroik.

Nga përrallat kanë hyrë: *figura të personazheve mitike* (orë, zana, gjarpinj, përbindësja, arapë, bajlozë), *personazhe si djali i vogël* (Omeri i Ri), *vajza të zgjuara* (Çika e plakut të moçëm), *motive që të kujtojnë ritet e inicimit* (prova të vështira të trimërisë për të fituar të drejtën e martesës), *objekte e sende të mrekullishme* (kali si ndihmës kryesor i heroit, shpata të helmatisura, topuzë magjike), *metamorfoza e transformime të mrekullishme* (ngurosjja e krushqve nga mallkimi i zanave), *shpirti i bartur* (te dhitë, pëllumbat, lepujt), *përfytyrime përrallore mitike mbi hapësirën dhe kohën artistike* (bodrumet e errëta dhe bota tjetër, ecjet e shpejta, mbyllësia e hapësirës me nisje nga kulla dhe kthimi i lumtur), *motra me vëllezër të plagosur për vdekje, që shndërrohen në qyqe, formulat e njëjta të hyrjeve e të mbylljeve, përfundimi i lumtur i subjekteve*.

Nuk është pa rëndësi edhe fakti se, krahas poezisë epike, në trajtën e përrallave në prozë qarkullojnë subjekte e personazhe të njëjta me ato të Mujit e të Halilit, të Gjergj Elez Alisë.<sup>15</sup> Ndonëse edhe përrallat janë krijime gojore me elementë fantastikë, mësimë morale dhe tregim imagjnativ s’do mend se shndërrimi dhe kapërcimi nga njëra formë zhanrore në tjetrën kërkon njohje të thellë të natyrshmërisë me të cilën realizohet rrëfimi në përralla. Për një rrëfimtari si Kuteli, i cili ka njohur karakteristikat e ndërtimit të këtyre formave të ndryshme të epikës gojore, kthimi nga materia e bërë për këndim epik në një materie (prozë gojore) e bërë për t’u rrëfyer, nuk i ka kushtuar natyrshmërisë as autenticitetit të gjinisë epike, madje ka pasuruar atë me forma të reja krijimi dhe interpretimi.

Si përfundim, ndikimi i folklorit në veprën e Mitrush Kutelit është një dëshmi e fuqisë së traditës kulturore për të formësuar dhe pasuruar krijimtarinë letrare. Kuteli, përmes tregimeve të tij, ka arritur të mbajë gjallë thelbin e baladave, këngëve dhe përrallave popullore, duke i integruar këto elemente në një formë të re që respekton dhe rikrijon burimin e tyre origjinal. Përmes përdorimit të teknikave të ndërthurjes së motiveve popullore me elemente moderne të prozës, ai ka krijuar një stil unik që jo vetëm që ruan trashëgiminë kulturore shqiptare, por edhe e pasuron atë me një dimension të ri artistik.

<sup>13</sup> Mitrush Kuteli, *Vepra letrare II*, Shtëpia botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1990, f.53.

<sup>14</sup> Mitrush Kuteli, *Tregime të moçme shqiptare*, Rilindja, Prishtinë, 1976, f.10.

<sup>15</sup> Zeqirja Neziri, *Epika gojore shqiptare*, Instituti AlbShkenca, Shkup, 2018, f.89.

Mund të themi se Mitrush Kuteli përveç fuqisë shprehëse, dialogut të gjallë, veprimt dramatik të personazheve të tij dhe transformimit të motiveve popullore, ndërmjet zhanreve të ndryshme letrare, ka trajtuar tema të cilat nuk janë thjesht në funksion të folkloristikës, të përpunimit të materies popullore apo të një invencionit letrar thjesht estetikisht të arrirë. Ky mjeshtër i rrëfimit, ka trajtuar tema të realitetit shqiptar të një rëndësie tejkohore. Krijimtaria e Kutelit na kujton rëndësinë e ruajtjes së lidhjeve tona me të kaluarën dhe me rrënjët tona kulturore.

Ndërsa ne ecim përpara dhe përpiqemi të përballemi me sfidat e reja, është thelbësore që të mos harrojmë traditat dhe historitë që na kanë formuar. Kuteli, me gjithë veprën e tij, ka arritur të ndërtojë një urë mes të shkuarës dhe të tashmes, duke na treguar se trashëgimia popullore mund të jetë një burim i pashtershëm frymëzimi dhe një forcë e madhe në krijimin e identitetit tonë kulturor dhe letrar. Në veprën e këtij autori, është i mbrujtur realiteti shqiptar në kuptim të përpjekjes për ekzistencë, të filozofisë jetësore dhe të vizionit të një të ardhmeje, jo në qasje profecie por në bashkëndërtim të një botëkuptimi të ri, pa kufij dhe pa barriera njerëzore, njësoj si në natyrën imagjinative të rrëfimeve të cilave ai mjeshtërisht u dha trajtën si jo të tjerë, përpara tij.

## Referencat

- [1]. Astrit Bishqemi, *Letërsia për fëmijë* SEIKO, 1997.
- [2]. Floresha Dado, *Proza nëpër teknikat poetike*, 2005.
- [3]. Mirlinda Krifca Beqiri, *Raporti i prozës së Mitrush Kutelit me letërsinë gojore*, Konferencë Shkencore “Mitrush Kuteli në 110-vjetorin e lindjes”, Universiteti “Fan Noli” – Korçë, 2017.
- [4]. Mirlinda Krifca Beqiri, *Studime letrare*, Shkup, 2013.
- [5]. Mitrush Kuteli, *Vepra letrare II, III; IV dhe V*, Shtëpia botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1990.
- [6]. Northrop Fraj, *Anatomia e kritikës*, Rilindja, Prishtinë, 1990.
- [7]. Sabri Hamiti, *Letërsia moderne shqiptare*, Albas, Tiranë, 2000.
- [8]. Sabri Hamiti, *Letërsia moderne shqiptare*, Albas, Tiranë, 2000.
- [9]. Sali Bashota, *Kuteli prozator, poet, kritik*, Rilindja, Prishtinë, 1999.
- [10]. Thomas A. Shmitz, *Teoria moderne letrare dhe tekste antike*, Albas, Tiranë, 2019.
- [11]. Tzvetan Todorov, *Hyrje në letërsinë fantastike* përkthyer nga Gjovalin Kola, Pika pa sipërfaqe, Tiranë, 2015.
- [12]. Zeqirja Neziri, *Çështje të letërsisë shqiptare II*, Instituti Alb-Shkenca, Shkup, 2023.
- [13]. Zeqirja Neziri, *Epika gojore shqiptare*, Instituti Alb-Shkenca, Shkup, 2018.